



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**V E N D I M**  
**K.P.P. 484/2018**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 19.07.2018 shqyrtoi ankesën me:

**Objekt:**

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të BOE “Gajd Company” sh.p.k. & “Kappa-Oil” sh.p.k., në procedurën e prokurimit, “*Procedurë e Hapur*”, me objekt “*Blerje Profilaktikë për auto (vaj, goma, bateri)*”, me nr. REF-58661-03-26-2018, me fond limit 10,833,800 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 19.04.2018, nga autoriteti kontraktor Ujësjellës Kanalizime Tiranë sh.a.

**Ankimues:**

BOE “Gajd Company” sh.p.k. & “Kappa-Oil” sh.p.k.  
*Adresa: “Rruga e Kavajës”, magazina një katëshe, pranë parkut të autobuzave, Tiranë.*

**Autoriteti kontraktor:**

Ujësjellës Kanalizime Tiranë sh.a  
*Adresa: Rr. “5 Maj”, pranë Medresesë, Tiranë.*

**Baza Ligjore:**

*Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik, i ndryshuar neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 184, datë 17.03.2010, “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar;*

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

## V ë r e n:

### I

#### *Vlerësimi paraprak*

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës, mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga BOE ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit. nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar.

I.2. BOE ankimues ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, i cili e ka refuzuar atë, dhe më pas ka paraqitur ankesë, me të njëjtin objekt, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e percaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”;

I.3. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

### II

#### *Rrethanat e çështjes*

II.1 Në datën 27.03.2018, në sistemin e prokurimeve elektronike është publikuar procedura e prokurimit, “*Procedurë e Hapur*”, me objekt “*Blerje Profilaktikë për auto (vaj, goma, bateri)*”, me nr. REF-58661-03-26-2018, me fond limit 10,833,800 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 19.04.2018, nga autoriteti kontraktor Ujësjetillës Kanalizime Tiranë sh.a.

II.2 Në datën 19.04.2018, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3. Në datën 16.05.2018, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarës, me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e rivlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezulton si më poshtë vijon:

- |   |                                       |
|---|---------------------------------------|
| 1. “Gajd Company” shpk & “Kappa-Oil” shpk     | 6,992,000 lekë pa tvsh Skualifikuar;  |
| 2. “Eximoil” shpk                             | 7,192,400 lekë pa tvsh Skualifikuar;  |
| 3. “R&R Company” shpk                         | 7,400,000 lekë pa tvsh Skualifikuar;  |
| 4. “RA-MI Kompani” shpk                       | 8,900,000 lekë pa tvsh Kualifikuar;   |
| 5. “Kadiu” sha                                | 9,336,900 lekë pa tvsh Kualifikuar;   |
| 6. “Si & CO Company” shpk                     | 9,724,000 lekë pa tvsh Skualifikuar;  |
| 7. “Auto Start Group” shpk                    | 10,407,000 lekë pa tvsh Kualifikuar;  |
| 8. “Luar Bros” shpk & “Poëer Industries” shpk | 10,454,000 lekë pa tvsh Skualifikuar; |
| 9. “Sinani Trading” shpk                      | 10,656,000 lekë pa tvsh Skualifikuar; |
| 10. “MuhoPlus” LTD                            | 10,735,500 lekë pa tvsh Skualifikuar; |

II.4.Nga verifikimet e kryera, rezulton se BOE “Gajd Company” sh.p.k. & “Kappa-Oil” sh.p.k. është njoftuar nëpërmjet Sistemit e Prokurimeve Elektronike (S.P.E.) për skualifikimin e ofertës së tij, në procedurën e mësipërme të prokurimit, për arsyen si më poshtë vijon:

“Pas pranimit të ankesës së paraqitur nga BO ”Gajd Company” shpk & ”Kappa Oil” sha, për procedurën e prokurimit me objekt ” Blerje Profilaktikë për auto(vaj,goma,bateri)”, për nevoja të Autoritetit Kontraktor, u konstatua se oferta e paraqitur nga ana e Operatorëve Ekonomikë të sipërcituar, me vlerë 6.692.000(gjashtë milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e dy mijë) lekë pa tvsh rezultoi anomalisht e ulët. Në këto kushte në zbatim të nenit 56 te ligjit nr. 9643,date 20.11.2006”Per Prokurimin Publik”i ndryshuar shprehimisht thuhet..... 1)Kur AK verën se nje ose me shume oferta per kontratat e mallrave ,puneve apo sherbimeve jane anomalisht te uleta ai perpara se te vazhdoje me procesin e vleresimit te ofertave i kerkon operatorit ekonomik perkates te paraqese me shkrim dhe brenda 3 diteve pune shpjegime per elementet e vecante te ofertes per: a)anën ekonomike te metodes se ndertimit ,procesit te prodhimit apo sherbimeve te ofruara b)zgjidhjet teknike te ofruara dhe ose ndonje kusht favorizues te jashtezakonshem qe ka ofertuesi per kryrjen e punimeve ,per furnizimin e mallrave apo te sherbimeve c)origjinalitetin e puneve ,mallrave apo te sherbimeve te propozuara nga ofertuesi d)zbatueshmerine e detyrimeve qe lidhen me mbrojtjen ne pune dhe kushtet e punes ne vendin ku do te kryhet apo ku do te sigurohet furnizimi.... Në zbatim të dispozitave të mësipërme, Komisioni I Vlerësimit të Ofertave, më datë 09.05.2018 iu drejtua operatorëve ekonomikë , nëpërmjet sistemit elektronik të APP-së, për të paraqitur sqarimet e tyre lidhur me ofertën anomalisht të ulët të konstatuar nga Komisioni I Vlerësimit të Ofertave. Në datë 11.05.2018, Operatorët Ekonomikë depozituan pranë UKT-sha, shkresën, hyrë me nr. prot 1326 , mbi shpjegimin e elementëve të ofertës anomalisht të ulët. Nisur nga sa më sipër, shoqëria “Gajd Company” shpk, sqaron se kjo shoqëri, operon në tregun formal të tregtimit me shumicë dhe pakicë të artikujve, goma, bateri etj. Sipas argumentimit të operatorit ekonomik “Gajd Company” shpk, bilanci është rentabël, me kapacitete të mjaftueshme njerëzore, teknike dhe financiare. Sipas argumentimit të shoqërisë “Gajd Company”në pronësi të shoqërisë figurojnë magazina,dyqane funksionale,si dhe shoqëria nuk është debitore ndaj institucioneve të ndryshme shtetërore.Gjithashtu operatori ekonomik krahas argumentimit ka bashkëngjitur totalin e magazinës të artikujve goma,fatura doganore,si dhe fatura tatimore shitje. Ndërsa përsa i përket argumentimit të paraqitur nga Operatori Ekonomik “Kappa Oil” sha në bashkëpunim me Operatorin Ekonomik “Gajd Company” shpk, citohet se: ...Së pari shoqëria “Kappa Oil” sha, është një nga shpërndarësit më të mëdhenj të vajrave lubrifikant dhe baterive në Shqipëri e cila ka realizuar kontrata direkte me prodhuesin duke siguruar çmime më konkurruese në treg. Së dyti Kappa Oil siguron një xhiro vjetore të konsiderueshme çka bën të mundur operimin me marzhe fitimi më të ulëta në krahasim me operatorët e tjerë në treg. Së treti çmimet e ofruara janë realisht çmimet që firma jonë aplikon për shitjen me shumicë. Referuar dokumentacionit të paraqitur nga Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë, konstatohet se “Kappa Oil” ka bashkëngjitur vetëm shkresën me lëndë “Shpjegime lidhur me ofertën e paraqitur” datë 10.05.2018, dhe asnjë dokumentacion

tjetër provues. Nga verifikimi i këtij dokumentacioni dorëzuar nga operatorët ekonomikë në mbështetje të ofertës së paraqitur në procedurën e mësipërme të prokurimit, rezulton se ky dokumentacion nuk është konform kërkesave të përcaktuara në ligjin dhe rregullat e prokurimit publik. Konkretisht operatori ekonomik “Kappa Oil” sh.a pretendon se ka kontrata direkte me prodhuesit duke siguruar çmime konkurruese në treg, por që nuk ka paraqitur pranë UKT sh.a asnjë lloj kontratë për të provuar këtë fakt, nuk ka paraqitur as fatura tatimore shitje apo faturë zhdoganimi etj. Pra, operatori ekonomik nuk ka paraqitur asnjë lloj dokumentacion provues pranë UKT sh.a, mbi pretendimet e dhëna në sqarimin e ofertës anomalisht të ulët. Përsa më sipër, theksojmë se, barra e provës mbi argumentin e ofertës anomalisht të ulët iu përket operatorëve ekonomikë, oferta e të cilit është konstatuar si e tillë, nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave. është detyrë e operatorëve ekonomikë, oferta e të cilëve është konstatuar anomalisht e ulët të paraqesin prova shkresore para Autoritetit Kontraktor në lidhje me origjinalitetin e punëve, mallrave apo të shërbimeve, të propozuara nga ofertuesi. Gjithashtu, Operatorët Ekonomikë, duhet të vërtetojnë zbatueshmërinë e detyrimeve, që lidhen me mbrojtjen në punë dhe kushtet e punës, në vendin ku do të kryhet puna, shërbimi apo ku do të sigurohet furnizimi. Pra, të dy operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dokumentacion provues për argumentimin e ofertës anomalisht të ulët. Bazuar në arsyetimin dhe faktet e shtjelluara më lart, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave gjykon se nga ana e Bashkimit të operatorëve ekonomikë – oferta e të cilit në zbatim të formulës të përcaktuar në legjislacion ka dalë anomalisht e ulët, janë paraqitur sqarime dhe dokumentacion jo i plotë që të argumentojnë ofertën anomalisht të ulët (në kuptim të: metodës së përzgjedhur, zgjidhjeve teknike të posaçme, kushte përjashtimisht favorizuese që gëzon ofertuesi apo origjinaliteti i punës së propozuar), duke mos krijuar bindjen se kjo ofertë është e rregullt në të gjithë elementët e saj me qëllim garantimin e një kontrate të suksesshme. Referuar nenit 1 gërma “b” “Objekti dhe qëllimi” i ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se “Objekt i këtij ligji është përcaktimi i rregullave që zbatohen për prokurimet e mallrave, të punëve dhe të shërbimeve nga autoritetet kontraktore të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; Mirëpërdorimi i fondeve publike përfshin jo vetëm përzgjedhjen nga autoriteti kontraktor të ofertave më të ulëta (si kriter i përzgjedhjes së ofertës fituese referuar “çmimit më të ulët”), por gjithashtu shmangien e risqeve dhe dështimin e kontratës që mund të vijnë nga oferta anomalisht të ulëta, referuar formulës së përlllogaritjes të parashikuar në ligj. Sqarojmë se risku që mund të shfaqet nga një ofertë anomalisht të ulët është në disa drejtime nga të cilat përmendim rrezikun për mos kryerjen e furnizimit në të cilësinë e duhur; rreziku i tërheqjes së operatorit ekonomik nga lidhja e kontratës dhe kosto që i lindin autoritetit nga mos kryerja e furnizimit brenda afateve kohore të parashikuara, humbjet që mund të pësojë në kohë nga mos kryerja e shërbimit gjatë periudhës së ri publikimit të procedurës së tenderit në rast të mos zbatimit të kontratës nga ana e operatorit ekonomik oferta e të cilit rezulton anomalisht e ulët. Bazuar në arsyetimin dhe faktet e shtjelluara më lart, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave gjykon se nga ana e Bashkimit të operatorëve ekonomikë – oferta e të cilit në zbatim të formulës të përcaktuar në legjislacion ka dalë anomalisht e ulët, janë paraqitur sqarime dhe

*dokumentacion jo i plotë që të argumentojnë ofertën anomalisht të ulët duke mos krijuar bindjen se kjo ofertë është e rregullt në të gjithë elementët e saj me qëllim garantimin e një kontrate të suksesshme. Rrjedhimisht Komisioni i Vlerësimit të Ofertave gjykon se nga ana e bashkimit të operatorëve ekonomikë nuk është sjellë argumentimi i ofertës anomalisht të ulët në respekt të nenit 56 të LPP-së, ndaj dokumentacioni i paraqitur nga ky operator nuk konsiderohet i vlefshëm. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të pikës 5, të nenit 53, të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”,nenit 56 pika 2 i ndryshuar dhe mbështetje të Kreu VII, neni 66, pika 3, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e shpall të pavlefshme këtë ofertë pasi pas shqyrtimit të shpjegimit të ofertës anomalisht të ulët nuk bindet se është e rregullt në të gjitha elementët e saj.”*

II.5.Në datën 17.05.2018 BOE ankimues “Gajd Company” sh.p.k. & “Kappa-Oil” sh.p.k., ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar vendimin e KVO-së për skualifikimin e ofertës së tij, në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi.

II.6.Nga verifikimet e kryera në dokumentacionin e paraqitur pranë KPP, me anë të shkresës Nr. 13733/1 Prot. datë 18.05.2018, autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje BOE ankimues “Gajd Company” sh.p.k. & “Kappa-Oil” sh.p.k., në datën 21.05.2018, duke mos e pranuar ankesën.

II.7.Në datën 25.05.2018 BOE ankimues “Gajd Company” sh.p.k. & “Kappa-Oil” sh.p.k. ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtin objekt me ankesën e paraqitur në autoritetin kontraktor, për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi duke argumentuar si më poshtë vijon:

*“[...]Ne Date 04.05.2018 Shoqerite tona bejne Ankese prane Autoritetit Kontraktor duke e shoqeruar Ankesen me te gjitha mandat pagesat e detyrimeve qe pretendonte Autoriteti Kontraktor. Ne dt 09.05.2018 me Nr 12854 / 1 Prot ne ambjentet tona vjen nje shkrese ne cilen Autoriteti Kontraktor gjykon se pretendimi jone qendron dhe ankesa pranohet. Ne po kete date 09.05.2018 ne faqen tone te prokurimeve publike ëëë.app.gov.al Autoriteti Kontraktor dergon nje shkrese per argumentim te ofertes e cila sipas tij eshte anomalisht e ulet dhe per sa i perket dokumentacionit shoqerite jane ne rregull. Ne Date 11.05.2018 Shoqerite tona dorezojne argumentimin e ofertes per te gjitha zerat e artikujve qe ofertojne ne proceduren e tenderit te siperperrendur. Analiza e artikujve eshte bere nga ana e te dyja shoqerive dhe eshte dorezuar nga ana e shoqerise “Gajd Company”sh.p.k dhe ne vijim te te gjithë kesaj korrespondence ne dt 16.05.2018 Autoriteti dergon rikualifikim te ri duke e S’kualifikuar serisht shoqerine tone me pretekstin si me poshte vijon(Citim...) Ne dt 17.05.2018 Shoqerite tona bejne serisht ankese tek Autoriteti Kontraktor me argumentimin si me poshte vijon : Ne Lidhje me shpjegimin tone te ofertes e cila sipas jush rezulton anomalisht e Ulet Shoqeria jone ka bere nje Argumentim te te gjitha zerave te ofertes duke nxjerre koston reale per cdo artikull (goma,bateri, vaj). Duke qene se jemi nje Bashkim operatorësh dhe si te tille do bejme dhe furnizmin tek Autoriteti duam te thekojme se : Lideri*

i dy shoqerie tone Gajd Company Shpk me 66.34 % (sipas kontrates se bashkepunimit ) ka dhene nje shpjegim me te detajuar te gomave duke e shoqeruar me gjendjen e magazines dhe njekohsisht me faturat e blerjeve, sepse (gomat) per te cilat shoqeria do ofertoje nuk i prodhon por i tregeton pra ka llogaritur nje kosto mbi normen e tregetit te tregut qe operon. Per sa i perket Shoqerise “Kappa Oil“ eshte nje nga prodhuesit me te medhenj ne tregun Shqiptare, pra mallin qe disponon nuk e ka te magazinuar nga blerjet e furnitoreve te tjere por artikujt qe do bej furnizimin e Autoritetit tuaj Shoqeria Kappa Oil e prodhon. Pra, Duke qene se Kappa Oil eshte prodhues, koston e prodhimit dalin sipas formulimeve perkatese per sejcilin vaj. Theksojme se formulimet jane pjese e sekretit tregtar dhe profesional, keshtu qe nuk ju mund t’ju japim detajet e formulimeve. Por kuptohet qarte qe referuar cmimeve te lendeve te para ne e kemi totalisht te mundur te ofrojme artikujt e kerkuar. Per te qene me te qarte nga ana juaj po paraqesim vetem deklaratat doganore dhe faturat e lendeve te para qe perdoren per prodhimin. Duke qene si lende e pare artikujt e ofruar nga ana jone kemi bere dhe argumentimin e ofertes te dhene ne date 09.05.2018. Duam te bejme ne dije qe: Duke qene nje nga shperndaresit me te medhenj ne Shqiperi me nje xhiro te konsiderueshme per te bere nje furnizim sa me te sukseshem dhe duke mos qene firma fantazem qe operojne ne tregun Shqiptar japim nje argumentim ne te cilen vet Autoriteti Juaj duhet te besoj ne vertetesine e saj sepse cdo cmimi i ofertuar e ka nje zanafill (te cilen ne po e vendosim bashkangjitur). Prodhimi nuk do te thote te shmangesh nga risku apo te mos realizosh nje kontrate me sukses. Ne Date 18.05.2018 Nr 13733/1 Autorteti “Ujesjelles Kanalizime Tirane“ Sh.a kthen pergjigje (Shkresa bashkangjitur) ne te cilen pretendon se Argumentimi i ofertes nuk eshte bere i sakte nga ana e shoqerive sepse Shoqeria “Kappa Oil” nuk e ka shoqeruar argumentimin e ofertes me dokumentacione per te vertetuar cmimin e paraqitur dhe njekohsisht nxjerr ne sistemin e App-se renditjen serisht te operatoreve ekonomik. Theksojme se : Ne lidhje me Arsyetimin qe “Ujesjelles Kanalizime Tirane ” Sh.a ka bere ne lidhje me kete procedure tenderi eshte teresisht i padrejte sepse : 1.Nje nga kriteret baze te vleresimit te ofertave eshte “Perzgjedhja e operatoreve Ekonomik sipas cmimit me te ulet“. Oferta e paraqitur nga ana jone eshte me nje dokumentacion shume te rregullt si ekonomik financiar ashtu edhe teknik. Pervecse dokumentacionit per te cilen jemi korrekt per prezantimin e tyre sa me te sakte ne kemi bere dhe argumentimin e ofertes per te gjithë zerat e ofruar, duke u bazuar ne fakte te dokumentave qe ne kemi disponibel. Sipas Autoritetit Shoqeria “Kappa Oil” nuk e ka argumentuar sic duhet analizen e cmimeve te artikujve. Ju bejme ne dije qe Shoqeria “Kappa Oil “operon ne tregun Shqiptar qe prej Vitit 1998, dhe duke qene me nje historik te madh ne tregetin dhe prodhimin e pjeseve te kembimit dhe lubrifikanteve di ta llogaris me se miri analizien e nje artikulli (ashtu sic e ka paraqitur prane Insitucionit tuaj). Po kjo shoqeri ju thekson se ne analizen qe ka paraqitur ka perdorur formule ekonomike per te nxjerre koston reale te produktit, por kjo formule eshte pjese e sekretit tregtar dhe profesional, keshtu qe nuk ju mund te jepje detaje te hollesishme te fakteve qe ju kerkoni. Ne ankesen e dyte shoqeria : “Kappa Oil” ka vendosur dokumenta te lendes se pare thjesht per tu treguar se nga vjen ky produkt por jo qe Autoriteti te kuptoj formulen se nga jane nxjerre llojet dhe nenproduktet e tjera. Per sa me larte ju qartesojme se Autortieti Kontraktor “Ujesjelles Kanalizime Tirane

*“Sha ka perball dy shoqeri te cilat pervcse jane te sakta me dokumentacion por ofrojne dhe mallra me standarte cilesore, te cilat nuk mund te S’kualifikohen per arsye te pakuptimshme dhe te pabazuara ne fakte. Mendojmë se ka mungese profesionalizimi dhe njohurish ne Vlerësimin e ofertave ekonomike sepse ky vleresim na jep te drejte te gjykojmë se është bere i paragjykuar dhe i njeanshme për te gjetur argument skualifikimi te këtij bashkimi operatoresh. [...]”*

II.8.Në datën 04.06.2018 autoriteti kontraktor me anë të shkresës nr.K-2409/1prot., datë 01.06.2018, ka dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik informacionin e kërkuar në lidhje me procedurën e prokurimit të sipërcituar.

### **III Komisioni i Prokurimit Publik**

pas shqyrtimit të ankesës, dhe kërkesës të BOE ankimues,

#### **Arsyeton:**

III.1.Lidhur me pretendimin e BOE ankimues “Gajd Company” sh.p.k. & “Kappa-Oil” sh.p.k. mbi skualifikimin e ofertës së tij, në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi me argumentimin : *“Ju bejme ne dije qe Shoqeria “Kappa Oil“ operon ne tregun Shqiptar qe prej Vitit 1998, dhe duke qene me nje historik te madh ne tregetin dhe prodhimin e pjeseve te kembimit dhe lubrifikanteve di ta llogaris me se miri analizien e nje artikulli (ashtu sic e ka paraqitur prane Insitucionit tuaj). Po kjo shoqeri ju thekson se ne analizen qe ka paraqitur ka perdorur formule ekonomike per te nxjerre koston reale te produktit, por kjo formule eshte pjese e sekretit tregtar dhe professional, keshtu qe nuk ju mund te jepte detaje te hollesishme te fakteve qe ju kerkoni. Ne ankesen e dyte shoqeria : “Kappa Oil” ka vendosur dokumenta te lendes se pare thjesht per tu treguar se nga vjen ky produkt por jo qe Autoriteti te kuptoj formulen se nga jane nxjerre llojet dhe nenproduktet e tjera.”*, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në nenin 56 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikon se: *“[...] 1. Kur autoriteti kontraktor vëren se një ose më shumë oferta për kontratat e mallrave, punëve apo shërbimeve janë anomalisht të ulëta, ai, përpara se të vazhdojë me procesin e vlerësimit të ofertave, i kërkon operatorit ekonomik përkatës të paraqesë me shkrim dhe brenda 3 ditëve pune shpjegime për elemente të veçanta të ofertës, për: a) anën ekonomike të metodës së ndërtimit, procesit të prodhimit ose të shërbimeve të ofruara; b) zgjidhjet teknike të ofruara dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm, që ka ofertuesi për kryerjen e punimeve, për furnizimin e mallrave apo të shërbimeve; c) origjinalitetin e punëve, mallrave apo të shërbimeve, të propozuara nga ofertuesi; ç) zbatueshmërinë e detyrimeve, që lidhen me mbrojtjen në punë dhe kushtet e punës, në vendin ku do të kryhet puna, shërbimi apo ku do të sigurohet furnizimi. 2. Autoriteti kontraktor i verifikon këto elemente duke u këshilluar me ofertuesin dhe në bazë të*

*informacionit të paraqitur. Autoriteti kontraktor mund ta refuzojë ofertën, kur edhe pas shqyrtimit të infomacionit të paraqitur nga ofertuesi, nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjitha elementet e saj[...]*”.

III.1.2. Në nenin 66 pika 5 të VKM nr.914 datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar parashikon se: *“Pas korigjimit të gabimeve aritmetike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon nëse ofertat e vlefshme janë ose jo me çmim anomalisht të ulët sipas formulës së përcaktuar në dokumentet standarde të tenderit. Përlllogaritja e ofertës anomalisht të ulët bëhet në mënyrat e mëposhtme: Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 56 të LPP, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% e fondit limit të përlllogaritur. Në rastin kur janë të vlefshme tre ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 56 të LPP, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme. Nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, komisioni I vlerësimit të ofertave duhet të kërkojë sqarime nga ofertuesit, përpara se të marrë vendim për kualifikimin ose jo të tyre, në përputhje me nenin 56 të LPP. Në çdo rast ofertuesi ka detyrimin të argumentojë dhe të dokumentojë me prova shkresore sqarimet për elementin/elementet e veçanta të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 56 të LPP. [...]*”

III.1.3. Nga interpretimi literal i nenit 56 pika 1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se barra e provës mbi argumentin e ofertës anomalisht të ulët i përket operatorit ekonomik, oferta e të cilit është konstatuar e tillë nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave. Gjithashtu, K.P.P. gjykon se argumentimi i ofertës anomalisht të ulët njëherazi duhet të plotësojë katër kushte kumulative për ti dhënë garanci si edhe bindje autoritetit kontraktor. Së pari, operatori ekonomik ankimues duhet të dorëzojë në mënyrë të detajuar anën ekonomike të metodës së ndërtimit, procesit të prodhimit ose të shërbimeve të ofruara, gjithashtu duhet të paraqesë para autoritetit kontraktor zgjidhjet teknike të ofruara si edhe në raste të veçanta dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm, që ka ofertuesi për kryerjen e punimeve, për furnizimin e mallrave apo të shërbimeve. Gjithashtu është detyrë e operatorëve ekonomikë oferta e të cilëve është konstatuar anomalisht e ulët të paraqesin prova shkresore para autoritetit kontraktor në lidhje me origjinalitetin e punëve, mallrave apo të shërbimeve, të propozuara nga ofertuesi, si edhe së fundmi duhet të vërtetojë zbatueshmërinë e detyrimeve, që lidhen me mbrojtjen në punë dhe kushtet e punës, në vendin ku do të kryhet puna, shërbimi apo ku do të sigurohet furnizimi. K.P.P. gjykon se katër kushtet e mësipërme të parashikuara nga LPP, janë kushte kumulative të cilat më anë të provave shkresore dhe argumentimeve përkatëse duhen plotësuar nga operatorët ekonomikë ankimues, oferta e të cilëve rezulton anomalisht e ulët. Referuar nenit 56 pika 2 të LPP-së autoriteti kontraktor i verifikon këto elemente duke u këshilluar me ofertuesin dhe në bazë të informacionit të paraqitur. Autoriteti kontraktor mund ta refuzojë ofertën, kur edhe pas shqyrtimit të infomacionit të paraqitur nga ofertuesi, nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjitha elementet e saj. K.P.P gjykon se nga interpretimi i normës së mësipërme lidhet



drejtpërdrejtë me shmangien e riksut që mund të sjellë një ofertë e cila rezulton anomalisht e ulët. K.P.P. gjykon se risku që shfaqet në rast se një ofertë rezulton anomalisht e ulët është në disa drejtime ku ndër të tjera si: rreziku për mos kryerjen e shërbimit/punëve në cilësinë e duhur; rreziku i tërheqjes së operatorit ekonomik nga lidhja e kontratës dhe kosto që i lindin autoritetit nga mos kryerja e shërbimit brenda afateve kohore të parashikuara; humbjet që mund të pësojë në kohë nga mos kryerja e shërbimit gjatë periudhës së ri publikimit të procedurës së tenderit në rast të mos zbatimit të kontratës nga ana e operatorit ekonomik oferta e të cilit rezulton anomalisht e ulët. Gjithashtu, K.P.P. thekson se referuar nenit 1 gërma “b” “Objekti dhe qëllimi” i ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se “Objekt i këtij ligji është përcaktimi i rregullave që zbatohen për prokurimet e mallrave, të punëve dhe të shërbimeve nga autoritetet kontraktore të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; Mirëpërdorimi i fondeve publike përfshin jo vetëm përzgjedhjen nga autoriteti kontraktor të ofertave më të ulëta (si kriter i përzgjedhjes së ofertës fituese referuar “çmimit më të ulët”), por gjithashtu shmangien e risqeve dhe dështimin e kontratës që mund të vijnë nga oferta të cilësuar si anomalisht të ulëta, referuar formulës së përlogaritjes të parashikuar në ligj.

III.1.4. Komisioni i Prokurimit Publik verifikoi ofertën ekonomike të BOE “Gajd Company” sh.p.k. & “Kappa-Oil” sh.p.k. dhe nga ky verifikim rezulton se, nga ana e këtij të fundit është paraqitur oferta ekonomike, plotësuar sipas zërave të kërkuara nga autoriteti kontraktor. Nga llogaritjet e kryera nga Komisioni i Prokurimit Publik, referuar bazës ligjore si më sipër cituar (shiko pika III.1.2.), rezulton se oferta e BOE ankimues është anomalisht e ulët dhe sipas informacionit të autoritetit kontraktor, rezulton se edhe Komisioni i Vlerësimit të Ofertave e ka konstatuar këtë fakt, dhe ka kërkuar që nga operatori ekonomik të paraqitej analiza e çmimeve të ofruara, me anë të shkresës nr.9747/8prot, datë 09.05.2018. Nga shqyrtimi i informacionit dhe dokumentacionit të paraqitur nga autoriteti kontraktor rezulton se nga ana e BOE “Gajd Company” sh.p.k. & “Kappa-Oil” sh.p.k, me synim justifikimin/argumentimin e ofertës anomalisht të ulët është dorëzuar dokumenti datë 11.05.2018, “Argumentimi dhe analiza e kostos për cmimet e paraqitura në tenderin me objekt “Blerje Profilaktikë për auto (vaj, goma, bateri)”” për zbërthimin e zërave të ofertës.

III.1.5. Nga verifikimi i bërë nga Komisioni i Prokurimit Publik rezulton se operatori ekonomik “Kappa-Oil” sh.p.k, i cili bazuar në kontratën e bashkëpunimit nr.1116rep, nr.957kol, datë 16.05.2018, ka marr përsipër të kryej furnizimin me mallrat “Bateri” dhe “Vajra”, me anë të shkresës dërguar autoritetit kontraktor datë 11.05.2018, ka bërë argumentimet (analizë) përkatëse mbi koston e cmimeve të ofruara për produktet e objekt prokurimi të marra përsipër në kontratën e bashkëpunimit të sipërcituar, por nuk e ka shoqëruar me dokumentacion provues, për ta mbështetur këtë analizë. KPP gjykon se operatori ekonomik “Kappa-Oil” sh.p.k, ka patur detyrimin që analizën e cmimeve të dërguar pranë autoritetit kontraktor, për mallrat “Bateri” ta shoqërojë me dokumenta provues (fatura blerje, fletë zhdoganimi etj), pasi në këtë analizë, operatori ekonomik

“Kappa-Oil” sh.p.k ka deklaruar që do të jetë mall importi dhe jo i prodhuar nga ky i fundit sikurse pretendohet në ankesë. KPP riktheson se barra e provës mbi argumentin e ofertës anomalisht të ulët i përket operatorit ekonomik, i cili duhet të jap analiza sa më të sakta dhe të shoqëruara me dokumenta provuese për të bindur autoritetin kontraktor. Bazuar në arsyetimin dhe faktet e shtjelluara më lart, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se nga ana e BOE ankimues, oferta e të cilit në zbatim të formulës të përcaktuar në legjislacion ka dalë anomalisht e ulët, janë paraqitur sqarime të cilat nuk provohen me dokumentacionin përkatës, duke mos krijuar bindjen se kjo ofertë është e rregullt në të gjithë elementët e saj me qëllim garantimin e një kontrate të suksesshme. Rrjedhimisht Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se nga ana e BOE ankimues “Gajd Company” sh.p.k. & “Kappa-Oil” sh.p.k nuk është sjellë argumentimi i ofertës anomalisht të ulët në përputhje të plotë me nenin 56 të LPP-së, ndaj oferta e këtij bashkimi operatorësh ekonomik duhet të qëndrojë e skualifikuar nga ana e autoritetit kontraktor.

Sa më sipër, pretendimi i BOE ankimues nuk qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, nenit 28 të VKM-së nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

**Vendos:**

1. Të mos pranojë ankesën e BOE “Gajd Company” sh.p.k. & “Kappa-Oil” sh.p.k për procedurën e prokurimit, “Procedurë e Hapur”, me objekt “Blerje Profilaktikë për auto (vaj, goma, bateri)”, me nr. REF-58661-03-26-2018, me fond limit 10,833,800 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 19.04.2018, nga autoriteti kontraktor Ujësjellës Kanalizime Tiranë sh.a.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit të sipërcituar.
3. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Nr. 978 protokollit Datë 23.05 .2018**

**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Nënkryetar**  
**Enkeleda Bega**

**Anëtar**  
**Vilma Zhupaj**

**Anëtar**  
**Lindita Skeja**

**Anëtar**  
**Merita Zeqaj**

**Kryetar**  
**Evis Shurdha**